


# BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër  
Viti II i botimit, Gusht 2008 Nr. 16. Çmimi 20 lekë.  
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj



## DUHET TE MARRE FUND PERRALLA E MARIN BARLETIT PER HISTORINE E SKENDERBEUT

Për një brez të tërë qytetarësh që kanë jetuar diktaturën sllavo-komuniste dhe kanë marrë për tëvërtetë historinë e Skenderbeut që e paten servirur historianët e saj te njohur, Aleks Buda dhe Stefanaq Pollo, të cilët i paten interpretuar faktet dhe dokumentet historike në linjën politike të ideologjise së kësaj diktature për figurën e Skenderbeut, do t'u duket blasfemi që të rishkohet me një realizëm të ri roli i kësaj figure historike të popullit shqiptar e cila ka pozuar për ne shqiptarët si një model që e ka shpëtuar Shqipërinë nga Perëndoria Osmane pas një qendrese, që më shumë se realiteti luftarak ,mbart tipare të një legjende, ku ngjarjet paraqiten bardh e zi dhe fitorja është e sigurtë pa filluar mire beteja në të cilën turqit vriten me mijra dhe shqiptarët fitimtarë pësojnë humbje ne qindra. Për ta dhënë këtë figurë sa më mbresëlënëse, hystriografia e diktaturës u mbeshitet tek historiani humanist, Marin Barleti i cili e përclli këtë historinë e këaj figure me një pamje dhe trajtim romantik, shumë larg të vërtetës historike, gjë që u duk haptas tek kontestimi i figurës së Skenderbeut që u bë pas rënies së diktaturës, sepse studjuesit dhe historianët u trimëruan dhe filluan të japin fakte të reja historike të cilat e hoqën vellon romantike që ishte edhe e qëllimshme në trajtimin e figurës së Skenderbeut. Pamja e re e Skenderbeut, sipas një piste historike, që po mbizotëron në mediat e shkruara dhe vizive, është se luftëtari, që njihet si shpëtimtari i Shqipërisë, paska qenë një luftëtar që ka luftuar kundër turqve muslimanë në emër të një feje tjetër që është feja katolike dhe se pikërisht për këtë luftë të suksesshme ai qenka vlerësuar nga Evropa e krishterë që e emërtoi si kalorësi i krishterimit duke na lënë ne shqiptarëve pa heroin tone. Ata që e hedhin këtë tezë dhe e mbrojnë japin japin fakte se lufta e Skenderbeut ishte pjesë e një kryqzate ku u investuan nga Evro-



pa para te shumta dhe luftëtarë të huaj që Skenderbeu të fitonte betejat me turqit muslimanë dhe shumë muslimanë shqiptarë të njihnin edhe ashpërsinë e shpatës së Skenderbeut në qafën e tyre, kur ata nuk pranonin të konvertoheshin në katolikë. Interpretimet që u bënë nga ky këndvështrim ndihmuan për ta sjellë figurën e Skenderbeut si një figurë fetare ,duke e zbritur atë nga piadestali i madhështisë kombëtare ku ishte vendosur për një mijë e një arsye, më shumë jo të drejta ,sesa të drejta., ku spikaste linja e rrezikshmërisë më të madhe e armiqve që janë larg kufirit shqiptar se sa e atyre që janë pranë kufirit shqiptar për Shqipërinë dhe shqiptarët. Prandaj, përpjekjet që po bëhen për t'i dhënë një pamje religjoni bëmave të Skenderbeut, të bëjnë të dyshosh në qëllimin e vendosjes së portreteve të tij nëpër zyrat e institucioneve shtetërore të shqiptarëve dhe në ngutjen për ta vendosur statujen e Skenderbeut në sheshet kryesore të të gjitha hapësirave, ku jetojnë sot shqiptarët. Por, interes paraqet edhe studimi i bërë nga analistë dhe historianë që

kanë bërë përpjekje për ta paraqitur sa më afër reales figurën e Skenderbeut ,duke zbardhur veprimet , qëllimet dhe strategjinë tij e cila më shumë i është afruar dëmeve që i ka sjellë Shqipërisë vepra e tij ,sesa vlerave për të cilat kishin aq nevojë shqiptarët në ata vite. Sipas tyre, Skenderbeu nuk ndoqi rrugën e vasalitetit me Sulltanin e Turqisë, por e prishi atë duke filluar një luftë që e shkretoi vendin dhe e la atë në meshirën e fqinjëve, kur Shqipëria e bë shtet i pavarur. Vetëm rruga e vasalitetit, të cilën ndoqi Serbia , Greqia dhe shtete të tjera të mbuluara nga sundimi i Perëndorisë Osmane, ishte më optimalja dhe më me kosto të ulët për Shqipërinë e atyre viteve. Por, duket se Skenderbeu e quajti më të drejtë të bëhej vasal i Papatit dhe i Evropës së krishterë dhe të luftonte turqit në emër të këtij vasaliteti, gjë që solli rrënimin e vendit nga betejat e pafundme ,fitorja e të cilave edhe u hiperbolizua dhe u idealizua jashtë parametrave të së vërtetës, sepse kur turqit iu drejtuan Evropës, ata nuk ndoqën rrugën e hapësirës së Adriatikut, duke

e rrenuar me këtë vëprim strategjik ide në se Skenderbeu dhe shqiptarët ishin kështjella që mbrojtën Evropën e krishterë nga turqit muslimanë. Por, është edhe një arsytim që duhet të jetë më i pranueshmi i cili kërkon t'u thuhet e vërteta shqiptarëve për figurën e Skenderbeut i cili ka të bëjë me kërkesën në vazhdim të qeverisë turke për të rishikuar mardhënjet historike të shqiptarëve me Perëndorinë Osmane dhe në veçanti atë të Skenderbeut, sepse ajo që shqiptarët dine për këtë moment historik nuk është i vërtetë. Qeveria turke dhe kryeministri Erdogan vazhdojnë t'i kërkojnë historiografisë shqiptare se e vërteta për figurën e Skenderbeut gjendet vetëm në arkivat turke dhe pikërisht këtu duhet të mbeshiteten studimet e saj për t'i dhënë fund përrallës së Marin Barletit për historinë e Skenderbeut, një përrallë sllavo- ortodokse dhe me prapavijë ideologjike ku fijet i kanë tërhequr dhe vazhdojnë t'i tërheqin qendra që ua servirin si luftë fetare, luftën që kanë bërë shqiptarët kundër turqve, që për hir të së vërtetës, në më shumë se 500 vjet, zë një hapësirë kohore mikroskopike, sepse shqiptarët kanë vetqeverisur Perëndorinë Osmane së bashku me turqit dhe pikërisht në ata vite shqiptarët arritën majat e administrates dhe shkëlqyen në karrierë të cilën ia afroi historikisht vetëm Perëndoria Osmane. Prandaj ,përpjekja që vazhdon të bëhet edhe sot për të mbajtur të ndezur armiqësinë në mes të turqve dhe të shqiptarëve, duke e pompuar atë artificialisht dhe pa një mbështetje me vërtetësi historike, ku figura e Skenderbeut po luan rolin e një muri ndarës është antishqiptarizëm dhe e rrezikshme për Shqipërinë dhe për shqiptarët.

Selim Gokaj

Shkodër me 26.7.2008

**TURQIA SHTYLLE E GJEOPOLITIKES SE DOBISHME PER ÇESHTJEN SHQIPTARE**  
ABDI BALETA

fq. 2

**NJE ROMAN I RI QE SFIDON BEN BLUSHIN**  
ABEDIN RAKIPI

fq. 3

**GALLATE E MADHE ME KOSOVEN DHE KOSOVARET**  
SELIM GOKAJ

fq. 4

**ALL-LLAHU I DO ATA QE MBAJNE DREJTESINE**  
ZEMRIJE XHEMAJLI

fq. 5

**AFERSIA E PRINDERIT NDAJ FEMIJES SE TIJ**  
ZYMER RAMADANI

fq. 6

**ARRESTOHET VRASESI GJAKATAR I MUSLIMANEVE TE BOSNYES**  
ALBAN KASTRATI

fq. 6

# Turqia është shtyllë e gjeopolitikës së dobishme për çështjen shqiptare

Abdi Baleta

**Z**hvillimi më i rëndësishëm për shqiptarët në kohën e kësaj "krize Lindore" (1875-1881) ishte "shfaqja për herë të parë e nacionalizmit shqiptar, d.m.th. Lidhjes së Prizrenit... Dalja në arenën publike e nacionalizmit shqiptar në këtë kohë është e pamohueshme në kundërshtim me interpretimet e kundërta që duan ta paraqesin Lidhjen si një lëvizje reaksionare të drejtuar nga autoritetet osmane" (N. Klejer fq.246).

Mirëpo në Shqipëri ka shkruar si Gjetë Kola që i vihet punës me zell të madh për ta paraqitur Lidhjen e Prizrenit si një tubim të kotë fshatarësh analfabetë e të pagdhendur që vetën dinin të vinin gishtin e ngjyer me bojë mbi një copë letër. Ndërsa shqiptarët dhe Europa e kanë mësuar me kohë se Lidhja e Prizrenit ishte një organizim politik i paparë shqiptar në shkkallë kombëtare, që kërkonte vendin e vet në skenën politike e diplomatike europiane. Lidhjen e Prizrenit e frymëzuan dhe e përgatitën nga ana ideore burra të shquar dijetarë, e ngritën në këmbë dhe i prinë në beteja atdhetarë të përkushtuar, pashallarë të dëgjuar, klerikë me emër, pari e mençur popullore dhe për aq kohë sa ekzistoi ajo përmbushi detyra të mirëfillta dhe të vështira shtetërore.

Me shumë vlerë është përfundimi i parë kryesor që nxjerr Natali Klejer në mbyllje të studimit të saj: "Nacionalizmi shqiptar dhe më gjërësisht shqiptaria, nuk është pra aq i veçantë, siç thuhet në përgjithësi. Ai vendoset në të njëjtin kontekst, sikurse nacionalizmat tjerë ballkanikë në she-

kullin XIX" ( fq. 707). Me këtë ajo përforcon meritën e Lidhjes së Prizrenit.

Veçse ky nacionalizëm shqiptar, i lindur në të njëjtën kohë me nacionalizmat tjerë ballkanikë dhe në kushtet e rënies e shpërbërjes së Perandorisë Osmane, ndryshonte shumë në natyrën e tij nga nacionalizmat sllavë e grekë, kishte mision kryesor mbrojtës e jo ambicie ekspansioniste; ishte nacionalizëm që nuk ndikohej nga ndonjë fanatizëm fetar dhe as luante rolin e veglës së ndonjë shovinizmi shtetomadh jashtëballkanik. Kuptohet se nacionalizmi shqiptar nuk mund të kishite ndaj Perandorisë Osmane në rënie të njëjtat synime e të njëjtin agresivitet si nacionalizmat tjerë ballkanikë.

Mbase tani duhet thënë se veprimtarë të shquar të shqiptarizmit e përpunues të nacionalizmit shqiptar kanë gabuar në atë kohë kur e tepronin me akuza ndaj Perandorisë Osmane e me lebetitje të forta për fatkeqësitë e shqiptarëve nën këtë Perandori, duke shkruar me shpresën iluzore se kështu do të preknin telat e zemrave të europianëve që mbetën krejt të ngurta e të akullta dhe vetëm shtuan përçmimin dhe keqtrajtimin ndaj shqiptarëve. Një dukuri të ngjashme e kemi vënë re edhe pas vitit 1990 kur shumë politikanë e propagandistë shqiptarë e quanin trimëri të madhe e bëheshin demokratë të mëdhenj vetëm duke poshtëruar çdo gjë shqiptare të kohës së komunizmit.

Dihet se Perandoria Osmane, megjithë telashet e saj, e ndihmoi afirmimin e nacionalizmit shqiptar në kohën e "Krizës lindore" e të Lidhjes

së Prizrenit. Kurse Turqia e re (që për simpati ndaj shqiptarëve është si Rusia ndaj serbëve) prej dekadash është bërë një nga shtyllat kryesore të gjeopolitikës e të gjeostrategjisë amerikane në zonën e Ballkanit, të Mesdheut Lindor, të Lindjes së Mesme e tani të Azisë Qendrore, një hapësirë e gjërë që edhe për shumë kohë do të mbetet epiqendra e garave ekonomike, sidomos për naftën e gazin, e ballafaqimeve politike, kulturore, fetare dhe e konflikteve të mëdha gjeostrategjike botërore nga Adriatiku në Pamir e Gjirin Persik. Prandaj dora ngatërrestare ruse futet gjithandej për të trazuar Ballkanin dhe për këtë qëllim Kremli përpiket të shfrytëzojë problemin e Kosovës shumë përtej angazhimeve të tij për të mbështetur këlyshin e vet me të bindur, Serbinë.

Por Kremli vazhdon të punojë me të njëjtin stil në tërë boshtin politik-ortodoks në Ballkan, edhe pse tre shtete të kësaj zone Greqia, Bullgaria dhe Rumania tashmë janë në NATO e në BE. Në Moskë e dinë se stomakun këto shtete mund ta mbajnë në BE, por shpirti i tyre nuk ndahet nga Moska dhe herë pas here mund të përdoren si partnerë të saj në "ruletën ruse" në Ballkan ". E pamë fare qartë këtë menjëherë pasi Perëndimi e tha hapur se bisedimet shtesë 120 ditore shqiptaro-serbe treguan se është e kotë të vazhdohet më tej me bisedime për statusin Kosovës. Menjëherë u bënë bashkë tre anëtarët ortodoksë ballkanikë të NATO-s e të BE-së Greqia, Bullgaria dhe Rumania që t'u sugjeronin shqiptarëve të Kosovës të hynin sërish në bisedime për të arritur një

kompromis që të mos mbetej i zemëruar e të mos ndjehej i izoluar Beogradi. Nuk duhen shumë mend të kuptohet se pas kësaj nisme qëndron Moska. Ja pra, si vazhdon të funksionojë boshti politik-ortodoks në Ballkan. Nuk do shumë mend për të kuptuar se kush i jep direktiva udhëheqësisë kosovare që përballë veprimeve aktuale të këtij boshti të nisë sherrin diplomatik me Turqinë për hesape e mërira të para një shekulli e gjysmë, synon të privojë shqiptarët nga miqësia e mbështetja e Turqisë.

Një veprim i tillë është në shërbim për lojërat që kurdis blloku i ortodoksisë rusbalkanike në dëm të shqiptarëve. Prandaj janë "këshilla Djalli" ato që jep Engjëll Koliqi që shqiptarët e Kosovës, të sulmuar egërsisht nga ari rus e çakalli serb, të turren me mërira të vjetra për osmanët kundër Turqisë dhe të bëhen kështu mercenarë vullnetarë të gjeopolitikës së Rusisë në Ballkan. "Larjet e hesapeve" historike me Turqinë, siç propozon Engjëll Koliqi, janë lënie peng e interesave të shqiptarëve tek fajdexhinjtë e matrapazët e diplomacisë ruse e serbe.

*Materiali është botuar në gazetën "Republika"*

*Gazeta Besimtari e boton me miratimin e autorit.*

*Redaksia*

# NJE ROMAN I RI QE SFIDON BEN BLUSHIN

**Abedin Rakipi**

Unë përballë Blushit me:  
"Të jetosh në Çamëri"

Intervistë/Flet Abedin Rakipi, 26-vjeçari çam nga Berati e me banim prej vitesh në Bruksel, i cili ka vendosur të sfidojë Ben Blushin dhe romanin e tij "Të jetosh në ishull", duke shkruar si kundërpërgjigje po një roman

Ajo që nuk pritej po ndodh: romanit të Ben Blushit, "Të jetosh në ishull", po i përgatitet një kundërpërgjigje kokë për kokë, po me një roman. Them "ajo që nuk pritej, po ndodh", ngase deri më kritizimet e Blushit nuk e kanë kaluar dot cakun e një shkrimi në gazetë dhe tashmë që jehona e romanit të shumëpërfolur është shuar e bashkë me të dhe komentet "pro" e "kundër", vjen lajmi i një romani anti-Blush dhe me një titull tejet sinjifikativ, me një thagmë nga ankthi ynë mbarëkombëtar: "Të jetosh në Çamëri". Autori i romanit është pikërisht një 26-vjeçar me origjinë nga Filati i Çamërisë, i quajtur Abedin Rakipi, një aktivist dinamik i çështjes çame, i cili prej sa vitesh që jeton në zemër të Evropës, në Bruksel, ka bërë "djalë e dalë në mal", për atë copë të kafshuar mynxyrshëm nga trupit i kombit. Me një formim intelektual të avancuar për moshën, zotëruar në 7 gjuhëve të huaja, Abedin Rakipi ka studiuar fillimisht në kolegjin Mehmet Akif Ersoy në Tiranë, pasi ka ardhur nga qyteti i tij, Berati, e më pas studimet e larta i ka përfunduar në Bruksel. Atje ka qenë i angazhuar fuqishëm në ambientet socio-kulturore, duke marrë pjesë për pesë vjet rresht në forumin social evropian. Kjo pozitë i ka dhënë shansin të takohet personalisht me Kryeministrin e Belgjikës, Guy Verhofstadt, dhe me kreun e diplomacisë, Louis Michel, që momentalisht është edhe komisar i EU. Ai u ka parashtruar atyre tragjedinë çame. Po në këtë drejtim, Abedin Rakipi ka organizuar një protestë në Hagë kushtuar çështjes çame e tashmë po merret me ndërtimin e një sajti gjigant në internet në aq gjuhë sa zotëron, pra shtatë, kushtuar Çamërisë, historisë, kulturës e tragjedisë që përjetoi shekullin e kaluar. Vitet e fundit, Abedin Rakipi u është kushtuar kërkimeve historike, duke u zhytur në arkivat prestigjioze evropiane e ato osmane. Dhe janë pikërisht këto kërkime të cilat e kanë ndihmuar për librin që do e hedhë së shpejti në treg, në kundërpërgjigje të romanit të Ben Blushit, "Të jetosh në ishull". Pikërisht për këtë shprehet në intervistën e mëposhtme 26-vjeçari sfidues...

Ju po shkruani një roman, që është konsideruar anti-Blush dhe me një titull tejet sinjifikativ: "Të jetosh në Çamëri". Cila është simbolika në këtë rast?

Që i vogël kam qenë një nga ushtarët e Çamërisë. Edhe pse isha ndoshta vetëm pesë vjeç, dashuria e thellë për ato vatra që gjyshi mi përcolli deri në zemrën time, m'u ngul në zemër përjetësisht dhe tek unë rritej gjithmonë ideja që më thoshte: Abedin duhet të bësh diçka për dheun tënd të larë me gjak dhe që gjyshërit ta lanë amanet, varret

e tyre akoma na thërrasin. Po nuk bëre gjë ti Abedin dhe çamët e tjerë, kush do ta bëjë vallë?

Dhe po dal direkt te pyetja juaj. Simbolika e romanit që unë po shkruaj me titullin "Të jetosh në Çamëri" dhe që është konsideruar anti-Blush, është se Blushi në romanin e tij e trajton islamin si fe pushtuesi, që i solli popullit tonë vetëm të këqija dhe që populli ynë ka vuajtur shumë nga kjo fe dhe ka luftuar mjaft për të ruajtur të drejtat e tij kombëtare. Ai thekson faktin se shumë shqiptarë kanë vdekur për të mos e ndryshuar fenë e tyre dhe që islami u është imponuar me dhunë nga pushtuesi turk. Romani im është konsideruar anti-Blush, sepse aty trajtohen vuajtjet që ka jetuar populli i Çamërisë pikërisht për faktin se ishin myslimanë, duke filluar që nga vitin 1821 me revolucionin grek, ku filluan spastrimet e para etnike ndaj myslimanëve të Çamërisë së Jugut, Artës dhe fshatrave përreth. Çamët deri vonë janë ftuar nga grekët dhe priftërinjtë e tyre që ta ndryshojnë fenë, me kusht që të mund të qëndronin në Çamëri. Me qindra janë dëshmitë e çamëve të ardhur në Shqipëri që tregojnë sesi priftërinjtë shkonin fshat më fshat duke i ftuar që të ndryshonin fenë e tyre dhe pastaj të mund të rrinin të qetë në Çamëri.

Pra, nisur nga fakti që çamët kanë vuajtur shumë nga dhuna fetare dhe etnike e ushtruar nga Kisha Ortodokse Greke dhe shteti grek, unë denjoj me këtë roman që t'i tregoj popullit shqiptar se faqet e historisë sonë, të cilat janë të mbushura me urrejtje antiturke, rezervojnë shumë pak të dhëna për trojet shqiptare të Çamërisë; ka vetëm disa faqe, që edhe gjenocidin e tmerrshëm që ndodhi në Çamëri mezi e tregojnë. Pra, Blushi, i cili pretendon se populli shqiptar ka vuajtur shumë nga islami dhe turqit, duhet që të mësojë se ne kemi vuajtur më shumë nga greko-sllavët.

Si u ngjiz te ju ideja e një romani, derisa opozicionet ideore kundrejt Blushit deri më tani kanë qenë vetëm shkrime të llojit "kritikë"?

Siç e theksoni edhe ju, opozicionet ideore kundrejt Blushit deri më tani kanë qenë vetëm kritikë gazetareske dhe kjo gjë ka bërë që romani i tij të ketë një popullaritet dhe një publicitet shumë të madh. Por unë mendoj se pas disa muajsh apo vitesh kritikën harrohen, ose më saktë zhduken, kurse romani ngelet si vepër artistike edhe pas vdekjes sime e të Blushit, ndaj mendoj se duhej një mënyrë më efikase për t'i treguar popullit tonë se ekziston edhe "volte face" i romanit të Blushit dhe se e vërteta ka shumë fytyra, gjithmonë varet nga këndvështrimi dhe idetë që ajo mbron. Ideja për t'u kundërpërgjigjur me një roman, ishte e menjëherëshme tek unë, pasi nuk po kuptoja se si asnjë intelektual mysliman nuk po arrinte të kishte vërtet një reagim që do të baraspeshonte rëndësinë historike dhe emocionale që ka romani i Blushit,

ndaj i thashë vetes: Abedin, ti duhet ta bësh dhe fillova shkrimin e romanit.

Si ju ra në dorë romani "Të jetosh në ishull"?

Për romanin e Blushit kam dëgjuar për herë të parë në forumin virtual internetik "Çamëria" me mbi 650 anëtarë. Në këtë forum, të cilin e kam krijuar dhe e drejtoj vetë, diskutohet rreth çështjes çame dhe Çamërisë. Ai është bërë një fole, ose një vatër për çamët anembanë botës. Prioriteti ynë është informimi i popullsisë shqiptare dhe opinionit botëror rreth çështjes çame. Në këtë forum u postuan disa kritika rreth Blushit, gjë kjo që ngjalli kuesh-tjen time dhe që më shtyu ta blija dhe ta lexoja romanin.

Kur nisët ta lexonit, kishit ndonjë dozë paragjykimi që në fillim (nisur nga emri i autorit), apo patët startin e një lexuesi që nuk e dinte se ç'do të ndodhte fletë pas flete?

Romanin e vlerësova shumë, sepse Blushi është vërtet një shkrimtar me një potencial artistik shumë impresionues dhe u mundova që mos të kem asnjë paragjykim kur fillova leximin e romanit dhe faqe pas faqe i nënvizova frazat ku kishte pasaktësi historike, ku kishte deformim të ngjarjeve dhe ndodhive historiko-fetare dhe ku kishte urrejtje të hapur ndaj islamit, gjithashtu dhe fraza ku kishte ftesë të hapur për ta braktisur fenë e tyre islame. Gjithsesi, ajo që më shqetësoi nuk ishin fyerjet që i bën Blushi islamit, sepse nuk është i pari, por fakti që ai mundohet ta justifikojë këtë platformë fyerjesh me fakte historike të sajuara, që janë shumë larg së vërtetës.

Konkretisht ku gabon Blushi?

Blushi gabon në shumë vende. Mund të ketë gabime në çdo roman a libër të një tjetër profili, nisur nga papërsosmëria njerëzore. Ka dhe gabime të paqëllimita në këtë sens. Por nuk është thjesht gabim kur Blushi lëshon fyerje të tmerrshme kundër islamit dhe kur barazon myslimanët me kafshët. Kjo shkon ndesh edhe me humanizmin, sepse asnjë qenie njerëzore i çfarëdolloj feje apo etnie qoftë ai, nuk mund të barazohet kurrë me kafshët, qoftë edhe në një roman.

Pastaj, ai gabon, sepse sjell fakte historike të pavërteta.

Por gabimi që për mua nuk mund t'i falet Blushit është se ai përpiket që të mbështesë historinë që ofron në roman dhe ta tregojë atë si një realitet vërtet i jetuar nga populli shqiptar në një moment të caktuar, duke e bazuar atë mbi gënjeshtër, iluzione dhe ndërtim realitetesh virtuale.

Por vetë Blushi dhe mbrojtësit e tij shprehen se romani si i tillë ka brenda dhe imagjinatën e për këtë nuk mund të gjykohej sikur të ishte vepër e mirëfilltë historike. A mjafton dhe është e drejtë kjo lloj alibie?

Alibia e Blushit dhe e mbrojtësve të tij, se romani nuk mund të gjykohej si

vepër historike e mirëfilltë, sepse ai ka brenda imagjinatën, besoj se mund të jetë një justifikim i mirë për të përligjur gabimet e pafalshme historike, për të cilat besoj se Blushi është koshient. Kur një shkrimtar i mirëfilltë nis një vepër kaq kolosale, e prek një periudhë kaq delikate të popullit tonë dhe një temë kaq të ndërlikuar, siç është marrja e islamit nga shqiptarët, duhet të bëjë gjithçka që burimet e tij historike të jenë në mënyrë perfekte të sakta dhe pastaj t'i japë romanit ngjyrën ideologjike që ai dëshiron. Por kur autori nuk denjon as të japë burime të vërteta historike që prekin "mollën e kuqe" të shqiptarit, që është feja, identiteti dhe historia e tij, kjo tregon një neglizhim diletant nga një shkrimtar që pretendon se është serioz dhe i mirëfilltë. Ose, ose, çka është më afër logjikës, autori vetë nuk ka dashur të japë fakte historike të vërteta, sepse ndoshta ato mund të binin ndesh me ngjyrën ideologjike që ai ka dashur t'i japë romanit. Pra, ose këto fakte historike thjesht nuk kanë ekzistuar, ose nëse kanë ekzistuar kanë qenë anti-"Të jetosh në ishull". Kjo nuk mund t'i falet një shkrimtari që pretendon se ka shkruar "Kodin e Da Vinçit" shqiptar.

Blushi është gjykuar për romanin e tij edhe si një cenues deri diku i harmonisë fetare. A e merrni ju parasysht këtë normë vitale të shoqërisë sonë, apo mjafton t'i thyni hundën tjetrit?

Romani i Blushit vërtet ka qenë cenues i harmonive fetare në Shqipëri, sepse në një moment mjaft delikat ai i bashkëngjitet ftesës së bërë nga Kadare dhe një grupi të caktuar njerëzish, myslimanëve shqiptarë, për të braktisur fenë e tyre. Pra, ai futet në kuadrin e platformës së madhe denigruese që po i bëhet fesë islame në Shqipëri, për të mos i lënë pjesës myslimane zgjidhje tjetër, veçse braktisjen e islamit dhe kthimin në të ashtuquajturën fe e të parëve. Unë personalisht nuk e denjoj një gjë të tillë në romanin tim; dua vetëm që populli shqiptar ta dijë se ka edhe një të vërtetë tjetër, që i fshihet atij nga Blushi dhe mbrojtësit e tij dhe më pas opinionin të zgjedhë vetë mes këtyre dy të vërtetave, evidencialisht duke e ftuar atë që të verifikojë burimet historike të këtyre dy veprave dhe asaj që ato përfaqësojnë në aspektin ideologjik. Do të përpiqem të ruaj në maksimum linjën e brishtë të harmonisë fetare në Shqipëri, duke u munduar që të mos lëndoj askënd.

Dhe së fundi, kur do dalë romani juaj?

Romani im del në muajin dhjetor të këtij viti, nëse çdo gjë shkon mirë.

*Materiali është marrë nga gazeta "Shqip"*

27.07.2008

# QEVERIA HEQ NGA KARTA E IDENTITETIT FIGUREN FETARE TE NENE TEREZES

Tedi Blushi

Kombësia dhe feja nuk do të jenë pjesë e elementëve përbërës të kartës së identitetit. Lajmi konfirmohet nga zv/ministri i Brendshëm, Ferdinand Poni. Në një prononcim të djeshëm për GSH, ai sqaroi se "heqja e tyre nga dokumenti më i ri identifikues i shtetasve shqiptarë, është marrë me një vendim të Këshillit të Ministrave". Ndërkohë që nuk ka preferuar të komentojë më gjatë mbi arsyet që detyruan qeverinë të marrë këtë vendim. Futja e elementëve të kombësisë dhe fesë si pjesë përbërëse e elementëve të kartës së identitetit, ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e minoritetit grek në vendin tonë. Kërkesë që ka marrë kështu një përgjigje ne-

gative në mënyrë zyrtare nga ekzekutivi shqiptar. Kombësia aktualisht është pjesë përbërëse e dokumenteve të identifikimit të shtetasve shqiptarë, sikundër janë certifikata dhe pasaporta. Sa i përket fesë, ajo asnjëherë nuk ka bërë pjesë në elementët e dokumenteve të mësipërme, për shkak se në Kushtetutë sanksionohet që Shqipëria është një shtet laik.

**Nënë Tereza**

Nga karta e identitetit është hequr gjithashtu edhe portreti i shenjtores katolike Nënë Tereza, ndonëse në variantin fillestar kjo gjë ishte parashikuar. Këtë e ka konfirmuar dje për GSH zëdhënësi i Ministrisë së Brendshme, Fatmir Konja, i cili iu referua një sqarimi të bërë nga drejtori

i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, Armand Teliti. Sipas Konjës, në kartat e identitetit do të shmanget dhe vendosja e portreteve të figurave të tjera historike të shtetit shqiptar. "Ajo çka mund të konfirmoj, është fakti se ky dokument do të përmbajë stemën e Republikës së Shqipërisë", - përfundon Konja. Heqja e portretit të shenjtores Nënë Tereza nga kartat e identitetit, vjen pas ankesës që u bë pranë kryeministrit Berisha nga kryesia e Këshillit të Përgjithshëm të Bashkësisë Islame të Shqipërisë. "Në kartën e identitetit, portreti i shenjtores katolike, Nënë Tereza me kryq në qafë, konsiderohet nga Bashkësia Islame si shkelje e dispozitave të Kushtetutës sonë dhe si diskriminim për besimtarët e fesë islame",

- thuhej në letrën ankimore që Komuniteti Mysliman i ka dërguar Berishës.

**Elementët**

Përbërësit e gjendjes civile të kartës së identitetit do të jenë Emri, Mbiemri, Atësia, Amësia, Ditëlindja, Vendlindja dhe Numri i identitetit. Këto elemente do të vendosen në anën e përparme të kartës. Kurse në anën e pasme do të vendosen gjatësia, ngjyra e syve, nënshkrimi i mbajtësit, numri serial i kartës, data e lëshimit dhe ajo e skadimit.

*Materiali është marrë nga gazeta "Shqiptare"*

29.07.2008

## GALLATE E MADHE ME KOSOVEN DHE KOSOVARET

**N**ë një emision televiziv, shikuesit, që e ndoqën atë, e djenë vehten të shqetësuar nga një parullë e cila ishte e shkruar në asfalt ku lexoheshin qartë këto fjalë ;Shkëlqimi dhe rënia e Pavarësisë së Kosovës.. Në shikimin e pare, një parullë e tillë të duket absurde. Por, po të shikojmë si kanë vazhduar të zhvillohen ngjarjet në Kosovë, pas shpalljes së Pavarësisë, detyrohesh që këtë parullë në asfalt ta quash të drejtë, pohim ky sa i dhimshëm, aq edhe tronditës. Tashmë është e qartë se faktori ndërkombëtar është ai që e planifikoi dhe e organizoi betejën për Pavarësinë e Kosovës, pa lënë në heshtje edhe luftën që bëri populli i Kosoves ,e cili ishte e mbështetur totalisht në të gjitha drejtimet nga faktori ndërkombëtar ku primadonë ishte ShBA, rol të cilin vazhdon ta luaj deri sa të realizohet strategjia e vertetë që është ndërtuar për fatin e Kosoves dhe të gjithë rajonit të Ballkanit.Të gjithë jemi dëshmitarë të manifestimit madhështor të të gjithë shqiptarve, kur Kosova e shpalli zyrtarisht Pavarësinë e saj dhe po të gjithë jemi dëshmitarë të rrjedjes së ngjarjeve që pasuan

me një pike referimi që ishte larg parametrave të një Pavarësie të vertetë , e thenë ndryshe, e një Pavarësie neletër, ku e zgënjyer sot është politika kosovare dhe ajo mbarë shqiptare dhe më të zhgënjyerit janë kosovarët e thjeshtë që po shikojnë haptas se në Kosovë po instalohet një pamje territoriale ku prania serbe është tashmë një logjikë e imponuar dhe e pranuar nga faktori ndërkombëtar në dëm të Kosoves dhe të kosovarëve. E fshehur pas një truku të sajuar strategjikisht, ku gogoli është Rusia , ndaj Kosovës po luhet një simfoni e zymtë e cila do ta ketë finalen e saj edhe më të zymtë se këtë fillim që po e përcjellim ne sot.Kosova sot është e blinduar nga forca ushtarake dhe policore që veprojnë në këtë hapësirë shqiptare me një mandat që quhet mandat paqëruajtës të cilit nuk i dihet qëllimi i tij i vërtetë, sepse këta forca janë shumë aktive dhe kërcënuese për të goditur dhe vrarë qytetarët kosovarë dhe shumë tolerantë dhe zemërbutë pëballë pakicës serbe dhe serbëve të Serbisë që hyjnë dhe dalin në Kosovë duke e dhunuar vijën kufitare të saj ,sikur ajo të ishte një vijë starti sportive.. Paradoxet dhe gallata me Kosovën

dhe kosovarët po shkallzohet rrezikshëm, megjithëse në dukje shumë rozë dhe tepër e maskuar për t'u lexuar nga njerëzit e thjeshtë, sepse ky është qëllimi i atyre që po e mbajnë de fakto prezencën serbe në Kosovë, mbajtja e përgjumur dhe e dizinformuar e kësaj shtrese të popullsisë së Kosovës që ajo të jetë e paralizuar në këtë fazë delikate, kur Kosova po bëhet nuse me një dhëndër ku shkusia po bëhet nga faktori ndërkombëtar që nesër nusja e re , Kosova t'i bindet deri në infinit vjehrrës së vjetër të saj ,Serbisë që zyrtarisht OKB ia ka lënë me rezultutën 1244, Mitrovica është pika nga do të vërshojnë metastazat sebe në të gjithë hapësirën kosovare.

Dhe metaztaza e pare e kobshme për Kosovën, teorikisht të pavarur ,e nxori kokën e saj në zgjedhjt lokale që u bënë në Kosovë, ku pakica serbe votoi si pjesë e Serbisë duke krijuar stuktura paralele ne një shtet që e quan vehten shtet i pavarur. Dhe të mos harrojmë se politikanët serbë që hynë në Kosovë nuk ishin ordinierë ,por presidentë dhe kryeministra të Serbisë , radikalë deri në ekstrem që i kanë duart dhe shpirtin e tyre të ngarkuar me krime dhe gjakun

e boshnjakëve dhe kosovarve muslimanë, të cilëve ua paten djegur shtëpitë dhe xhamiat , i paten vrarë dhe nuk do të nguronin përsëri që të ngrinin më lart kurbën e krimin dhe të genocidit ndaj tyre.Mediat po na krijojnë idenë se Pavarësia e Kosovës sot ka një mbështetje të fuqishme ndërkombëtare dhe se miljaradat po shkojnë drejt Kosovës, sikur të ishin para që po priten me gërshtë Por, duket se kjo është pjesë e gallatës që sot po luhet me Kosovën dhe kosovarët, të cilë kanë më shumë nevojë për një Pavarësi të vërtetë dhe pa trukime, se sa për miljona e miljarda dollarë të cilët duket se i shërbejnë më shumë atyre që i financojnë, se sa atyre për të cilët janë destinuar të shkojnë. Shqiptarët duan që kjo gallatë të marrë fund sa më shpejt dhe po kaq shpejt të prishen planet për ndarjen e Kosovës,sepse Kosova ka qenë dhe do të jetë gjithmonë e kosovarëve dhe perpjeket për ta tjetërsuar këtë pronësi kanë qenë fatale për projektuesit dhe zbatuesit e këtij tjetërsimi .

*Selim Gojaj  
Shkodër me 25 korrik 2008*

# ALL-LLAHU I DO ATA QE MBAJNE DREJTESINE

## Zemrije Xhemali

**F**alënderimi i takon All-llahut. Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga All-llahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzojnë All-llahu s'ka kush e largon dhe kë e largon nga rruga e vërtetë, s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër përveç All-llahut, i Cili është Një dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij. Allahu i Madhëruar në një ajet Kur'anor thotë: "O ju besimtarë, keni frikë All-llahun dhe thuani fjalë të drejta. Ai (All-llahu) ju mundëson të bëni vepra të mira, jua shlyen mëkatet e juaja, e kush respekton All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, ka shpëtuar me një shpëtim të madh." (El-Ahzab:70: 71) Morali i mirë është cilësi e pejgamberëve, burrave të drejtë të mirë dhe të devotshëm. Me moral të mirë arrihen grada të larta dhe pozita të lakmuara. All-llahu xh.sh. ka veçuar pejgamberin e Tij me një ajet ku ia ka përmbledhur të gjitha cilësitë e mira dhe vyrtet e larta, duke thënë: "...dhe vërtetë ti (Muhammed) je në një shkallë të lartë karakteri" (El-Karia: 5). Morali i mirë shkakton dashuri reciproke dhe afirim me njerëzit, kurse morali i keq shkakton urrejtje, zili dhe largim nga njëri tjetri. Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s. i ka nxitur muslimanët në moral të mirë dhe në të kapurit për te, bile edhe e ka përmbledhur në një vend

me devotshmërinë, kur thotë: "Më së shumti që hyjnë njerëzit në xhennet, hyjnë me devotshmëri dhe moral të mirë". (Tra. Tirmidhiu dhe Hakimi). Moral i mirë është: buzëqeshja, bërja mirë, largimi i të këqijave nga njerëzit, thënia e fjalëve të mira, përmbajtja nga hidhërimi, dhe bërja durim, etj. Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s. ka porositur Ebu Hurejren r.anhu me një porosi të madhe, duke i thënë: "Ebu Hurejre, kapu për moralin e mirë. Ebu Hurejreja r.a. i tha: ç'është morali i mirë, o i Dërguar i All-llahut? Ai tha: "Ta vizitosh atë që nuk të viziton, t'ia falësh atij që të bën zullum dhe t'i japish atij që nuk të jep". (Tra. Bejhakui). Shtrohet pyetja a punojmë ne sot në ket kohë në ket mënyrë: a) Ta vizitojmë atë që nuk na ka bërë asnjher zijaret, b) Tia falim atij që na ka bërë zullum, c) dhe ti japim atij që kurnjher nuk na ka dhënë, mesiguri se jo, këtë nuk e bëjmë, dhe nuk e praktikojm për ate se nuk jemi të pregatitur moralisht dhe fetarisht, neve na mungon Imani i plot, nuk jemi të kompletuar në aspektin fetar. E themi këtë nga aspekti i shumë fakteve dhe argumenteve që po na ndodhin neve për çdo ditë. Duhet të mendojm rreth gjurmëve të mëdha dhe shpërblimit që i ka ky vyrtet dhe kjo veçori. Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s. thotë: "Njeriu me moralin e tij të mirë arrihet shkallën e agjëruesit dhe falësit gjatë natës". (Tra. Ahmedi). Pejgamberi s.a.v.s. e konside-

roi moralin e mirë si plotësim të imanit, duke thënë: "Njeriu me iman më të plotë është ai që ka moral më të mirë". (Tra. Ebu Davudi dhe Ahmedi). Gjithashtu në një hadith tjetër Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s. thotë: "Njeriu më i dashur te All-llahu është ai që më së shumti u bën dobi njerëzve, kurse vepra më e dashur te All-llahu është gëzimin që e futë në zemër të një muslimani, largimin e ndonjë brenge prej tij, larjen e ndonjë borxhi të tij, ose largimin e urisë prej tij. Të eci me një vëlla timin musliman për ndonjë nevojë të tij është më e dashur për mua sesa të qëndrojmë në itakaf në xhami një muaj". (Tra. Taberaniu). Musliman i është urdhëruar të thotë fjalë të lehta dhe të buta që të regjistrohen në peshojën e veprave të tij të mira. Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s. thotë: "Fjala e mirë konsiderohet sadaka (lëmshë)". (Tra. Buhariu dhe Muslimi). Bile edhe buzëqeshja që nuk i kushton aspak muslimanit, shpërblehet për te. Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s. thotë: "Buzëqeshja në fytyrë të vëllaut tënd konsiderohet sadaka". (Tra. Tirmidhiu). Udhë zimet pejgamberike në nxitje për moral të mirë dhe durimin e të këqijave janë të shumta dhe të njohura, kurse sjellja e tij është shembëlltëre që duhet patur në sjelljen e njeriut me vetveten, me gruan e tij, me fqinjët e tij, me muslimanët e dobët, me injorantët, bile edhe me mosbesimtarët. All-llahu xh.sh. thotë: "Mos

t'ju pengojë sjellja e keqe e një populli nga të sjellurit drejt me ta. Silluni drejt me ta, ngase kjo është më afër devotshmërisë". Duhet të kujdesemi që ta edukojm vetveten, ta heshtim hidhërimin dhe ti gëzojm njerëzit që janë përreth nesh, qofshin ata prindërit, grua, fëmijët, shokët, miqtë me sjelljen e mirë me ta, me fjalët e mira që ua themi, me buzëqeshje në fytyrë kur t'i takojm, duke shpresuar që të fitojm shpërblim nga ana e Zotit Fuqiplot për ket vepër të mirë. Duhet të iu përmbahemi këshillave të përgjithshme të Pejgamberit s.a.v.s., ku thotë: "Ke frikë nga All-llahu kudo që të jeshë, pasoje të keqen me një të mirë, e cila do ta shlyen këtë të parën dhe sjellu me njerëzit me moral të mirë". (Tra. Tirmidhiu). Na bëftë All-llahu i Lartësuar prej atyre për të cilët Pejgamberi Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: "Më i afër me mua në ditën e Kijametit do të jetë ai që ka moral më të mirë". (Tra. Ahmedi, Tirmidhiu dhe Ibn Hibbani). Pra edhe ne duhet të bëhemi prej atyre besimtarëve që në ditën e gjykimit të na peshojnë më shumë punët e mira, me të cilat do ta meritojm shëfatin e pejgamberit dhe xhennetin me rahmetin e madhë të Krijuesit të Përgjithshëm, Allahut Fuqiplot. Allahu na pasuroftë me moral të mirë dhe na udhëzoftë në rrugë të drejtë. Amin.

# RRUGA E DREJTE E BESIMTARIT MUSLIMAN

## Abdulkadir Haktanër

**K**ur nje njeri e ka ngarkuar vehten me gjynahe dhe vazhdon të rrise numurin e tyre, ai nuk duhet të harroje se pas ketyre gjynaheve është devijimi nga feja islame dhe ai nuk mund t'i eliminojë gjynahet duke i quajtur ato veprime që nuk paraqesin rrezik për futjen e tij në xehnem. Me arsyetime të tilla, njeriu behet pjesë e mohimit duke e pergaditur vehten pa dëshire që te jete pjesë e atyre që Allahu xh.sh. do t'i denoje me zjarrin e xhehnemit.

Njeriu mund të shpëtoje nga veseve të turpshme dhe nga morali i shthurur vetem duke qene nje besimtar i perkushtuar ndaj fese islame dhe demokracia është e dobishme vetem kur ajo është mrenda normave të fese islame. Ai që është rob i Allahut mund ta quaj vehten të shpetuar nga rreziku që paraqet për ate morali i shthurur që po na sulmon ne sot. Besimtari musliman duhet ta quaj vehten pjesë e moralit që ka patur profeti Muhammedi a.s. dhe zbatues i sakte i synetit të tij. Para Allahut ne duhet të jemi të gatshëm që te pranojmë gabimet tona ne kete bote që te perfitojmë nga meshira e Krijuesit tone. Pendimi i besimtarit është rrugë për te shpetuar nga rreziku që paraqesin për ate gjynahet e kesaj bote dhe mundesi e madhe për te shpetuar nga ndeshkimi ditën e Gjykimit ne botën tjetër. Historia

është deshmata se kur muslimanet kane perjetuar fene islame, ata kane perparuar dhe kane fituar betejet me armiqtë e tyre dhe kur ata kane devijuar nga parimet e fese islame, është pare se ata kane perjetuar fatkeqesi dhe kane humbur betejet me armiqtë e tyre.

Popuj që jane larguar nga feja sot kane mundesi shume te medha zhvillimit duke na detyruar te gjejme shkaqet që kane sjelle mbetjen tone ne shume drejtime te zhvillimit njerezor. Mendojme se disa nga shkaqet te cilat duhet t'i kerkojme ne rrallet tona për te kuptuar arsyet e kesaj prapametje te popujve muslimane ne ditet që po jetojme sot jan[ keto:

1. Në rrallet e muslimaneve sot është zbehur shume shpresa për e ardhmen e fese islame ne rrallet e bashkesive islame që nuk jane te kompletuara ne besim.

2. Drejtësia ne shoqerine e popujve muslimane është ne nje nivel shume te ulet për shkak te qeverive që sot jane instaluar ne vendet muslimane.

3. Armiqtë e Islamit kane arrite që te mbjellin armiqesine ne mes vete muslimaneve me njeri-tjetrin.

4. Muslimanet sot nuk jane ne gjendje që te dallojne shkaqet, perse ata duhet te jene besimtare dhe perse ky besim u garanton atyre lidhjen dhe

vellazerine me njeri tjetrin.

5. Shume muslimane jane bere pjese e egoizmit dhe nuk arrijne te kuptojne rrezikun që paraqet egoizmi për muslimanet, kur kemi parasysh se ai kultivon tek njeriu vese që sjellin shkaterrimin e moralit te nje shoqerie, ne rastin tone te asaj muslimane.

6. Shume muslimane jane bere egoiste dhe mendojne e veprojne vetem për interesin e kesaj bote dhe i jane shmangur besimit duke harruar se do te japin llogari ne botën tjetër për bemat e tyre ne kete bote. Nuk duhet te harrojme se perparimi permes egoizmit dhe veseve është i caktuar nga Krijuesi që te deshtojë. Për besimtarin, Allahu xh.sh. ka lejuar ata që jane te lejueshme dhe që jane pjesë e hallallit për nje besimtar musliman. Besimtari musliman duhet ta quaj vehten ushtar i Allahut dhe te jete nen urdherat e Allahut xh.sh. Ai duhet te veproje nen urdherat dhe mrenda ligjeve te Atij që jeta e besimtarit te jete e lehte dhe e fituar. Besimtari edhe mund te gabojë, por ai e ka rrugen për ta korigjuar kete gabim duke kerkuar falje tek Krijuesi i tij i cili është shume fales dhe shume meshirues.

**Brezi i ri i besimtarve duhet te ruhet nga kurthet e mohuesve që te mos behen pjesë e rruges se tyre që është rruga mohimit te Allahut xh.sh. e cila te ben që te perqafosh**

rrugen e devijimit nga feja islame që për besimtarin është nje vrasje fetare që e kalon vdekjen e zakonshme te nje njeriu. Te mos harrojme se për besimtarin drita e ndergjegjes se tij është dituria e fese islame dhe drita e mendjes se tij jane shkencat ekzakte te cilat, kur bashkohen tek besimtari, ai mund ta shohe te verteten. Mbeshetja vetem tek dijet e shkences e ben besimtarin te jete pjesë e mohimit te Allahu xh.sh. Ata që e perdorin patriotizmin për te perfituar nga vlera e larte e tij harojne se patriotizem te vertete jashte fese islame nuk ka për besimtarin, sepse dashuria për atdhe buron nga forca e besimit fetar që ka besimtari. Patriotizmi i vërtetë nuk mund të qëndroje pa fenë e vërtetë. Për besimtarin rendesi ka që ai te besojë se ka nje ringjallje dhe se ka nje lumturi te perjetshme e cila është e garantuar nga Allahu xh.sh. te cilat ai i ka rezervuar për krijesen me te dashur te tij që është njeriu. Mosbesimtari është gjithmone i torturuar, sepse e tmerron vdekja dhe se me vdekjen ai mendon se misioni i tij si krijese ka marre fund. Besimtari nuk duhet te mashtrohet nga te mirat e kesaj bote, sado madheshtore që te duken, sepse te gjitha keto nuk mund te arrijne as vleren e nje fruti nga kopshti i xhennetit që është gati për te prite besimtarin që ka bere pune te mira dhe sevape ne kete bote

# AFERSIA E PRINDERIT NDAJ FEMIJES SE TIJ

Zymer Ramadani

**N**ë shumicën e rasteve, çdo prind pohon se është i aftë që ta edukoj fëmijën e tij me atë edukatë që posedon vet ai. Por edhe e ka të vështirë të pranoj një propozim nga jashtë që të veproje me fëmijën e tij ashtu apo të mos veproje. Meqenëse koha ka ndryshuar shumë, rrethanat familjare janë dobësuar. Kur e themi këtë kemi parasysh raportet prind-fëmijë që ekzistojnë sot në bashkësinë dhe rrethin tonë. Nuk ka strehim tjetër pos prindërve të tij një fëmijë dhe për këtë ky strehim duhet të jetë shumë i shendosh dhe i pranuar për fëmijën. Kontakti më i shpeshtë i prindërve me fëmijën e tyre e shton dashurinë dhe lidhjen e njëri-tjetrit, sepse po u mësua fëmija kështu, ai gjithmonë do ndije nevojën e prindërve të tij. Në të kundërtën ai do të mbetet i etur për atë ngrohtësi që ia falin ata e sidomos nëna dhe në këtë rast atij i nevojitet që atë zbrazë tërë ta e plotësojë me diçka tjetër. Është e natyrshme që në çdo familje të ketë ndonjë problem apo pakënaqësi

në mes anëtarëve të saj, pasi që nuk ka familje pa probleme gjegjësisht të përsosur. Mirëpo ajo që kërkohet në këto raste është se problemet aktuale nuk duhet rritur, por duhet shkuar nga zvogëlimi apo likuidimi i tyre. Në atë mënyrë siç e fotografon fëmija familjen e tij, po ashtu edhe ai fillon të mendojë dhe se gjatë tërë jetës së tij do të ketë të vizatuar atë program. Ekzistojnë ca gjëra që shpesh herë prindi i përdor ndaj fëmijës së tij e të cilat janë shumë të rrezikshme dhe dëmshme për të. P. sh. një nga ato është se s'paku njëherë në javë i thotë fëmijës së tij "kur unë isha në ditët tua apo si ti..., kur isha unë i ri sikurse ti i bëja këto gjëra, punoja shumë, nuk ia ktheja fjalën e prindit, nuk e bëja këtë apo atë nuk e kaloja kohën kot" e shumë e shumë thënie tjera të cilat nuk ndikojnë pozitivisht në psikologjinë e fëmijës. Athua përse këto thënie ndikojnë negativisht tek fëmija? Kur ai të mërzhitet nga këto fjalë që ia thotë prindi, një ditë do të fillojë të mendojë edhe ai të kundërtën e prindit. Pra, përbalimi i fëmijës me fjalinë "kur un

kam qenë në moshën tënde" i jep të mendoj atij që të thotë kështu edhe nëse jo haptazi "edhe shkencëtarët apo kryetari i shtetit është në moshën tënde por janë shumë më ndryshe se ti". Gjithmonë fëmija do ta gjykojë këtë rast dhe kjo gjithmonë do të bëjë që ai të jetë agresiv ndaj fjalëve të prindit. Për t'i eliminuar këto gjëra, nëna dhe babai në mesin e shumë gjërave duhet që t'iu përmbahen edhe këtyre: a) Duhet të përpiqen që ata ta e kuptojnë kërkesën dhe psikologjinë e fëmijës e jo fëmija t'i mësojë dhe të adaptohet me kushtet e tyre, sepse ai është 3 ose 8 vjeç kurse ata 30. b) Duhet që gjithmonë dhe në çdo cep të jetës të jenë në një dialog me fëmijën e tyre e jo vetëm në kohën e problemeve kur paraqiten, c) Në këto raste bisedash me të, nuk duhet përdorur fjalë të rënda por vetëm fjalë dashurie dhe gjëra të bukura të cilat pozitivisht do të ndikojnë tek fëmija. d) Të mos shprehin shqetësimin dhe brutalitetin e tyre ndaj tij kur ai të thyej apo prish diçka shumë me rëndësi, sepse kjo fut frikë tek fëmija.

e) Të shtohet kujdesi ndaj tij kur shikohet televizioni. Për këtë shkak nëpër ca emisione televizive caktohet moshë e atyre që kanë të drejtë ta e shijojnë atë. f) Në vend të dhënies së këshillave gojore, të jemi shembull përmes sjelljeve tona ndaj fëmijës, sepse këto sjellje do të jenë shembull i tij gjithë jetën. g) Të mos harrojmë shembullin e Pejgamberit Muhammedit alejhi's-selam se ai kishte lozur me fëmijët e tij shumë sa që i mbante në qafë edhe kur falte namaz. Të mos harrojmë që të jemi prind sikurse ai, nënë sikurse Hadixhja (All-llahu qoftë i kënaqur me të). Një kushtim pak më i kujdesshëm ndaj fëmijës nga ana e prindërve do të largonte nevojën e dërgimit të fëmijës nëpër kopshtet dhe çerdhet fëmijërore, sepse këto janë hapur si nevojë e moskujdesjes së plotë ndaj fëmijëve. Andaj çdo nënë e di më së shumti nevojën e fëmijës së saj dhe ajo është e vetmja e cila mundë që të ia plotësojë kërkesat e birit të saj.

## ARRESTOHET VRASESI GJAKATAR I MUSLIMANEVE TE BOSNJES

Alban Kastrati

**M**ediat e shkruara dhe vizive dhane këto ditë një lajm që ka sjellë reagime nga këndvështrime nga më të ndryshmet i cili ka të bëjë me arrestimin e vrasësit gjakatar të muslimanëve boshnjakë, Radovan Karaxhiç, i njohur me nofken "Kasapi" për bëmat e tij të tmerrshme kundër muslimanëve të Bosnjes me të cilët ai dhe paneli i tij gjakatar kishte hesape për të larë të cilat lidheshin me urrejtjen patologjike të serbëve për muslimanët për të cilët "Kasapi shprehej duke thenë se duhen vlarë që fëmijë, sepse ata i priste një fat i tillë edhe kur të rriten. Për këtë mjek, që për çudi u bë udhëheqësi shpirtëror i serbëve të Bosnjes që në vitet 90, masakrat e egra kundër civilëve të pafajshëm boshnjakë u bënë për fajin e vetëm të tyre, se po rritej numuri i tyre në atë hapësirë që serbët e quanin rrezik për mbijetesën e tyre. Dhe si mjet për ta zgjidhur këtë shqetësim të tyre, ata planifikuan dhe hodhën për zgjidhje ne terren genocidin ku-

ndër muslimanëve i cili arriti kulmin tek ekzekutimi i tyre në Srebrenicë ku mijra muslimanë, nga më i riu deri tek më plakuri, u vranë sikur të ishin qen rruge me një plumb pas zverkut. Dhe ideatori i këtij akti makabër qëndroi i lire, që nga viti 1995, për t'u dorëzuar vetëm pak ditë më pare, që pastaj drejtësia të jape verdiktin e saj. Në këtë hark kohor të më shumë se një dekadë është folur e shkruar shumë se ku fshihej Karaxhiçi dhe kush mund të ishte prapavija që e mbronte atë dhe a kishte një marrëveshje secrete në mes të atyre që e mbajtën të ndezur për 4 vite me rrallë luftën në Bosnje për ta "Konservuar" më në ruajtje atë që kishte përgjakur civilë të pafajshëm në Bosnje. Shumë here u fol për kontrollë dhe daljen e tyre bllof në atë hapësirë ku informohej se ishte kriminel. Por të vërtetën do ta pohonte ministri i mrendshëm e qeverisë së sotme serbe i cili deklaroi se Karaxhiçin e kanë mbrojtur shërbimet inteligjente serbe dhe po këta shërbime ia dorëzuan atë drejtësisë duke na bërë të dyshojmë për

një skenar ku fijet e tij tërhiqen shumë larg Serbisë tashmë tashmë ka dale "E pa lagur" nga gjakderdhja që bëri në Ballkan në vitet 90 duke u mikluar dhe u vlerësuar tashti për mundësitë që të jetë shumë shpejt pjesë e familjes evropjane me të cilat, për hirë të vertetës, ka lidhje të reja dhe të vjetra, sidomos kur është fjala për të bërë luftëra, krime dhe genocide si ata të viteve 90 në ish-Jugosllavi. Askush nuk mund të besojë që Karaxhiçi mund të kishte qëndruar i lire në një hark kohor kaq të gjatë, pa qenë i mbrojtur nga një marrëveshje e niveleve të larta të cilat e pamundësonin daljen e tij para drejtësisë, sepse po këtë nivele të larta ia paten dhënë licensën për të masakruar 200 mijë muslimanë në Bosnjë për shkakun e rëndomtë se ata po rriteshin në numur dhe llogaritej që, në një kohë të shkurtrë, muslimanët do të ishin popullsi dominante në Jugosllavi, gjë që ata nuk mund ta pranonin. Janë këto nivele të larta ndërkombe të kërcënuan dhe paralajmëruan komandantët e ushtrisë muslimane në

Bosnje, që mos të avancojnë më, por të tërhiqen tek kufiri 51 me 49, sepse ndryshe do të kishin pasojat. Ka fakte, të cilat mediat e huaja po i bëjnë të njohura, për informacionin që kishin qendrat ndërkombëtare për atë që do të ndodhte në Srebrenicë. Tashti, që kriminelin është prapa hekurave, duhet pranuar se një punë e mirë është bërë dhe se kriminelin e pret Haga, ku do të dëshmojë për bëmat e tij të tmerrshme. Por, Haga është e njohur edhe për vendime të njëanshme. Ajo është njohur edhe për ndërprerje hetimesh, pasi i akuzuari ka vdekur nga sëmundje të papritura. Le të shohim se cili do të jetë dënimi i vërtetë i Radovan Karaxhiçit dhe sa do t'i qetësojë shpirtërat e atyre që nuk jetojnë më dhe të atyre që jetojnë duke pritur që të vihet në vend drejtësia që, kur është fjala për të dënuar vrasësit e muslimanëve, lë shumë për të dëshiruar.

Alban Kastrati  
Shkodër me 14 .7.2008

## Mirësevini në linjën e punimeve artizanale "Bilani"

Ne prodhojmë për ju punime artizanale me aplikime, me djegie dhe me gdhënie.

Prodhimet shiten me shumicë dhe pakicë.

Ju mirëpresim!

Adresa: Pranë bankës arabe në Shkodër  
Mobil: +355 69 20 72142  
E-mail: arditbilani@yahoo.com

**Punime artizanale me forma dhe madhësi nga me te ndryshmet, Ardit Bilani**  
**Adresa: Souvenir Shopping House, Prane Bankes Arabe**

## Jemi vëllezër muslimanë

Secilit nga ne i ka rënë rasti të shikojë lart në qiell një pamjen madhështore të pakrahasueshme, ku yjet janë një pjesë me shumë rendësi e këtij zbukurimi. Në Kuranin Famëlartë Allahu xh.sh. na ka thenë: "Ne ne qiell kemi krijuar yje dhe e kemi zbukuruar për ata që e shikojnë me vemendje." (El Hixher\16. Kjo thenie kuranore dhe të tjera si këto janë orjentuese për shkencën që studjon Kozmosin, sepse shkenca e astronomisë dhe degëzimet e saj kanë arritur t'i japin njerëzimit pamjet e jashtëzakonshme të Universit. Një shkencëtar i njohur i studimit të Universit, Dr. Zag-hul el Nexhari, shkruan se një kometë po udhëton me miliona vjet me një shpejtësi të madhe dhe përsëri është shumë larg planetit tonë. Ky pohim i tij na tregon se hapësira në Univers është e një madhësie të tillë që mendja njerëzore e ka shumë të vështirë që ta përcaktojë.

Bota, ku ne jetojmë, është një pikë mikroskopike në këtë Univers dhe pikërisht ketu Allahu xh.sh. i ka dhënë njeriut, që është krijesa më e përsosur e tij, gjithshka që atij i duhet për të jetuar duke i kujtuar se ai këtë jetë duhet ta jetojë me hallall, sepse llogaria për këtë para Krijuesit është e pashmagshme. Njeriu duhet të mos harrojë Ahiretin, sepse për këtë qëllim dhe për të bërë punë të mira është krijuar. Në Kuranin Famëlartë thuhet qar-

te: "O ju që keni besuar dhe bënë vepra të mira." Por njeriu është i obliguar edhe të ketë besim, sepse besimi dhe punët e mira janë dy rrugët më të mira që Krijuesi i ka rekomanduar krijesës se vet më të përsosur që është njeriu. Por, njeriu është defektos në realizimin e këtyre porosive të Krijuesit të Gjithësisë, gjë që e bën të ditur edhe Kurani Famëlartë kur thotë: "Ju keni për qëllim përjetimet e kësaj bote, ndërsa Allahu dëshiron për ju Ahiretin. Për fat të keq, sot njeriu është zhytur në gjynahe dhe rrugët që ai ndjek për të fituar sa me shumë nga kjo jetë janë të ngarkuara me vepra dhe qëllime të dyshimta, ku secili është në garë për të përmbysur tjetrin që të ketë më shumë pasuri e me shumë hapësirë për të jetuar sa më i kompletuar, duke harruar komshiun e tij a ka mundësi ai për të jetuar së paku minimalisht, veprime këto që i nxerr ata nga hallalli dhe i çon vetëm tek harami që ditën e gjykimit do t'i çojë ata në zjarrin e xhehnemit. Në Kuranin Famëlartë thuhet qartë: "Po ashtu (sikur u dhamë xhinëve dhe njerëzve përjetim), Ne i bëjmë sundues disa mizorë mbi mizorët e tjerë për shkak të asaj që vepruan Elen'Amë\129

Në këtë situatë të rrezikshme, ku ka hyrë njerëzimi, muslimani, me besimin e tij tek Krijuesi dhe me veprat e mira që ai duhet të bëjë në jetën e tij, duhet të jetë shembull për të gjithë të tjerët në am-

bjentin ku ai jeton, duke kapërcyer me çdo kusht përplasjet që janë në rend të ditës nga padija, interpretimet e gabuara të tezave fetare, diversionit që bëhet nga armiqtë e islamit dhe nga e keqja më e madhe që është injoranca. Por, muslimanët nuk duhet të harrojnë se ata janë vëllezër në besim dhe vëllazëria në besim është dukuria më e lartë e solidaritetit njerëzor. Methebet kanë ndryshime në mes të tyre, por si pikë referimi ata kanë Kuranin Famëlartë dhe hadithet e Profetit a.s. Po të shikojmë me kujdes faljen e namazit, do të pranojmë se pikërisht në namaz secili nga ne është pjesë e vëllazërisë muslimane. Besimtarët në këtë moment fetar janë pranë njëri tjetrit në një hapësirë që është xhamia. Ata i japin selam njëri-tjetrit dhe i kanë trupat e tyre thuarje të mbështetur tek njëri-tjetri. Por, armiqtë e fesë islame disa mospërputhje në mes të besimtarëve, që janë dukuri formale, bëjnë të pamundurën që t'i kthejnë në konflikte të armatosura në mes të tyre, duke krijuar gjakderdhje, ku muslimanët janë ata që e lajnë fushëbejën me gjakun e tyre. Një rol me rëndësi për të forcuar vëllazërinë muslimane kanë dijetarët muslimanë dhe hoxhallarët që bëjnë biseda para besimtarëve ditën e xhuma dhe ditën e tjera që janë të planifikuara për biseda fetare. Por, dijetari shqiptar islam, H. Vehbi Gavoçi, pasi e vlerëson grupin e madh të hoxhallarëve të rinj që kanë studjuar në vendet

islame, na kujton se ata duhet të jenë të kujdesshëm në bisedat e tyre, që të eliminohen informacionet fetare që të çojnë në dizinformim fetar, dukuri që ne kemi rastin t'i shohin në ambjete fetare dhe në aktivitete fetare të organizuara nga institucionet fetare. Allahu xh.sh. na porosit që muslimanët duhet të jenë si një trup i vetëm pranë fesë islame. Prandaj, në Kuranin Famëlartë thuhet: "Dhe se kjo është feja ime (që e përcaktova për ju), pra përmbajuni asaj e mos ndiqni rrugë të tjera e t'ju ndajnë nga rruga e Tij." Këta janë porositet e Tij që të ruheni." (El Enam153) Duke pasë si pikë referimi këtë ajet kuranor, Profeti a.s., në prani të disa miqve të tij, vizatoi në rërë një vijë të drejtë dhe pastaj i shtoi asaj disa degëzime duke thenë: "Vija e drejte është rruga e vërtetë e të udhëzuarve. Kurse të gjitha rrugët e tjera kanë në krye të tyre nga një shejtan i cili i thërret besimtarët për në atë rrugë"

Prandaj, që vëllazëria muslimane të qëndrojë dhe muslimanët ta ndjenë vëllazërinë e tyre vëllazë, ata duhet të ecin në vijën e drejtë që është vija e Allahut xh.sh. e pasqyruar në Kuranin Famëlartë dhe në hadithet e Profetit, Muhamedit a.s.

Kasem Zylja

Shkoder, me 23 korrik 2008

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ  
BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIME

Tregtojme  
**MISH HALLALL**

E XHUMA PUSHEM → BESNIK ALUSHI ISMETI

**Produkte Hallall**

**KLIENTË TË NDERUAR!  
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,  
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

**1- Produkte mishi hallall si:  
sallam, suxhuk etj.**

**2- Piceri hallall**

**3- Fast Food hallall**

**Ju keni të drejtë të blini ku të doni  
por hallalli i vërtetë është vetëm  
tek market "ISMETI"**

Adresa: Pranë teatrit "MIGJENTI"  
Cel: 0692101893

**EJANI TEK NE! FABRIKA E PERPUNIMIT  
TE DRURIT**

# ILIRIA

me pronar Haxhij Ilir Muja (aktivist dhe bami-rës Islam), ju afro-n prodhime nga me" të thjeshtat deri ne dhoma gjumi. Shërbehet ne kohe dhe me cilësi të larte:

**Prodhim dyer e dritare**

**Dhoma gjumi**

**Pajisje zyrash**

**Pajisje kuzhine**

**Dhoma fëmijësh**

**Pajisje për ambiente lokalesh**

Te gjitha këto me çmime konkurruese dhe me transport të garantuar falas. Ejani në fabrikën tone dhe do te mbeteni te kënaqur. Mund te kontaktoni me numrin e mobilit: 0692523565

